

## Takim pune për zbatimin e vendimeve gjyqësore në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Duke vlerësuar rëndësinë e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), ka nisur takimet me përfaqësues të institucioneve vendore.



Takimi i parë u zhvillua në ambientet e KMSHC-së, me përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë, ku u trajtuan problematikat e hasura në zbatimin e vendimeve gjyqësore, për nëpunësit civilë.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi) gjatë takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Tiranë, z. Eldi Hoxha, theksoi rëndësinë e koordinimit, për të adresuar vështirësitë e identifikuara, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si një domosdoshmëri për forcimin e sigurisë juridike dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të shërbimit civil.



Në përmbyllje të takimit, Komisioneri shprehu gatishmërinë e institucionit për të ofruar mbështetje profesionale në këtë drejtim dhe kërkoi vijimin e konsultimeve mes teknikienëve të fushës, me qëllim që i gjithë procesi konsultues të reflektojë rritjen e nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore në institucionet e administratës vendore.